



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE**

---

---

**VENDIM**

**Nr. 8, Datë 06.08.2010**

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- |                            |            |
|----------------------------|------------|
| - Znj. Anila Jani          | Kryetar    |
| - Z. Bashkim Sykja         | Nënkryetar |
| - Znj. Marsida Xhaferllari | Anëtar     |
| - Znj. Ledina Mandia       | Anëtar     |

në mbledhjen e tij të datës 06.08.2010, mori në shqyrtim praktiken e ofrimit të dy ofertave të Kompanisë Vodafone sh.a, perkatesisht: "Vodafone Card for all": ju perfitoni 60 minuta, te vlefshme per thirrjet kombetare, per vetem 500 leke (me TVSH) per 7 dite dhe "Paketa javore Vodafone Card": ju perfitoni 30 minuta kombetare, 30 sms, 50 MB internet për vetëm 400 leke (me TVSH) per 7 ditë.

Komisioni pas shqyrtimit të çështjes dhe dëgjimit të përfaqësuesve të Vodafone sh.a,

**VËREN SE:**

Informacioni i derguar me mesazhe (sms) tek abonentet e saj nuk tregon kohën minimale të tarifueshme, pas të cilës aplikohet çmimi për sekondë, që është 60 sekonda për paketën "Vodafone Card for all" dhe 30 sekonda për "Paketën Javore Vodafone Card".

Informacioni i sakte është vetëm në website të Vodafone sh.a, i cili nuk është i aksesueshem nga të gjithë abonentet.

Fjalja e fundit e tekstit të sms është "telefononi në 131", i cili nuk jep informacion të metejshëm, por abonenti rregjistrohet automatikisht për këtë paketë.

Kjo praktike nuk është në përputhje me Ligjin 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve, Pjesa IV – Praktikën e tregimit, Kreu I – Praktikën e padrejta tregtare:

- **nenin 15 pika 1**, sipas të cilit: "Një praktikë tregtare është çorientuese kur, duke konsideruar të gjitha tiparet dhe rrethanat e saj, si dhe kufizimet e mjeteve të komunikimit, jep të mangët informacionin, që i nevojitet konsumatorit mesatar për të qenë i informuar për të marrë një vendim dhe, në këtë mënyrë, e bën apo ka mundësi ta bëjë konsumatorin mesatar të marrë një vendim, të cilin, në të kundërt, nuk do ta kishte marrë".
- **nenin 13, pika 4/a** sipas të cilit "Praktikat tregtare vlerësohen të padrejta,

*veçanërisht, kur janë çorientuese, sipas përcaktimit në nenet 14, 15 dhe 17 shkronja "A" të këtij ligji; dhe*

- **nenit 13, pika 5**, sipas të cilit "*praktikat e padrejta tregtare janë të gjitha të ndaluara*".

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni mbështetur në nenin 15 pika 1; nenin 13, pikat 4 (a) dhe 5; nenin 52, pika 4 dhe nenin 55 të Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", si dhe në pikën 6/a, c të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008,

#### **VENDOSI:**

1. Kompania Vodafone sh.a të ndalojë menjëherë shkeljen,
2. Te marre gjithë masat për mos përsëritjen e praktikave të tilla.

**KRYETAR I KOMISIONIT**

**ANILA JANI**